



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

PDK

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2023 - 31 Dhjetor 2023



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3-6
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve	8
Informata të përgjithshme	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-14



Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë të PARTISË DEMOKRATIKE E KOSOVËS

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik “Partia Demokratike e Kosovës”(në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 9-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruar në seksionin e Bazës për Opinion të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2023, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin e përfunduar me këtë date, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

- Ashtu siç është shpalosur në shënim 8 të pasqyrave financiare subjekti politik ka prezantuar llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera në vlerë 178,984.68 euro me 31 Dhjetor 2023(31Dhjetor2022;Euro449,010.42) .Gjate auditimit tone ne kemi konstatuar se subjekti politik ka nënvlerësuar llogarit e pagueshme dhe suficitet nga vitet e mëhershme në vlerë 51,025.50 Euro. Për me tepër në gjithashtu nuk arritëm të marrim siguri në lidhje me vlerën e llogarive të pagueshme të shlyera në vlerë 142,500.00Euro.Prandaj ne duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit e kishim të pamundur të verifikojmë ekzistencën, plotësin dhe vlerën e llogarive të pagueshme me 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022.
- Gjate auditimit tone ne kemi konstatuar se subjekti politik ka 39 zyre-dege neper komuna e Republikës se Kosovës, subjekti politik ka të deklaruar shpenzime të qirasë për vetëm 2 nga zyrat e saj. Ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë vlerën e shpenzimeve të sakta të qirasë qe subjekti politik do duhej të prezantonte dhe nëse këto do të duhej të prezantoheshin në kategorinë e të hyrave nga kontributet në natyrë

Theksim i çështjes

Pa dashur për të kualifikuar me tej opinionin tonë në tërheqim vëmendjen për lexuesit e pasqyrave financiare në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- SP lidhur me blerjet, furnizimet e mallrave dhe shërbimeve nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim më efikas, dhe furnizime



me kosto ekonomike, transparente dhe menaxhim të drejtë të fondeve të subjektit politik. Për më tepër SP nuk ka aplikuar në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit financiar politika dhe procedura të veta për prokurim.

- Subjekti Politik e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj por megjithatë nuk është funksional dhe nuk është aplikuar tek të gjitha rastet e blerjeve dhe furnizimeve, ashtu siç parashihet në Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Pasqyrat Financiare të SP nuk janë të nënshkruara në harmoni me: Ligjin NR. 06/L-032, Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim: dhe me UA MF-Nr. 07/2019 Neni 8: Nënshkrimi i pasqyrave Financiare: Pika 2. Nëse drejtori Financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i certifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i certifikuar.
- SP për periudhën e audituar kishte me shume se një llogari bankare, gjegjësisht NLB, BPB si dhe një llogari në Raiffaisen Bank .

Çështje tjera

- Pasqyrat financiare të subjektit politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjerë dhe opinionin e tyre mbi këto pasqyra ka qenë i pa kualifikuar.

Përgjegjësia e drejtimit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një



auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
24 Qershor 2024

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	25,966.16	19,590.44
Pasuritë e paprekshme			0.00
Pasuritë tjera afatgjata			0.00
Total pasuritë afatgjata		25,966.16	19,590.44
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			0.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	1,087.30	36,757.23
Pasuritë tjera afatshkurtra		0.00	0.00
Total pasuritë afatshkurtra		1,087.30	36,757.23
Total pasuritë		27,053.46	56,347.67
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(418,996.82)	(479,814.05)
Suficiti / (deficiti) i vitit		233,939.10	60,817.22
Total Ekuiteti		(185,057.72)	(418,996.83)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera		25,966.16	19,590.44
Gjithsej detyrimet afatgjata		25,966.16	19,590.44
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	178,984.68	449,010.90
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	7,160.34	6,743.16
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		186,145.02	455,754.06
Gjithsej detyrimet		212,111.18	475,344.50
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		27,053.46	56,347.67

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		657,168.04	660,538.40
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	400.00	1,000.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		1,456.39	2,517.96
Të hyrat tjera nga shlyerja e detyrimeve		292,458.57	10,000.00
Gjithsej të hyrat për vitin		951,483.00	674,056.36
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	561,711.49	456,315.23
Shpenzimet e transportit	2	21,222.55	14,425.89
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	46,494.24	59,912.78
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	
Blerja e mallrave	2	3,872.09	585.41
Shpenzimet e përgjithshme	2	57,381.48	56,911.00
Shpenzimet e ndryshme	2	26,861.95	25,088.83
Gjithsej shpenzimet për vitin		717,543.90	613,239.14
Suficiti / (deficiti) për vitin		233,939.10	60,817.22

1. Informata të përgjithshme

Emri i plotë i Subjektit Politik është: Partia Demokratike e Kosovës, Akronimi:PDK, i regjistruar më dt. 12.10.1999, me selin qendrorë në , Prishtinë, Bulevardi “Nëna Terez” nr.9.

Kryetari i SP për vitin raportues (2022) është z. Memli Krasniqi.

Përfaqësuesi Financiar i SP është z. Muhamet Morina.

Pasqyrat Financiare të SP PDK janë përgaditur dhe prezantuar në pajtueshmëri me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 te Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 , Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e rezultateve preliminare të kontrollimit me datën 24 qershor 2024 ka dorëzuar në KQZ raportin final financiar me pasqyrat financiare të korigjuara si dhe ka plotësuar dokumentet e nevojshme si dokumentim të transaksioneve të ndodhura.

Subjekti Politik PDK përgjatë vitit 2023 ka pasur tri (3) llogari bankare aktive.

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	481,775.09	481,775.09	0.00
Kontributet pensionale të	25,506.67	23,333.00	2,173.67
Kontributet pensionale të	25,506.67	23,333.00	2,173.67
Tatimet në të ardhura personale	28,923.06	26,439.60	2,483.46
Beneficionet tjera	0.00		0.00
Gjithsej	561,711.49	554,880.69	6,830.80
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	0.00	0.00	0.00
Karburantet	1,793.34	1,793.34	0.00
Biletat e aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	12,0200.00	12,020.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e	4,490.63	4,490.63	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	2,918.58	2,918.58	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	21,222.55	21,222.55	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	22,284.43	16,706.9	5,577.46
Aktivitete kulturore dhe rekreative	8,671.64	8,671.64	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet	14,185.12	14,185.12	0.00
Shpenzimet tjeratë reklamave,	1,353.05	1,353.05	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni	46,494.24	40,916.78	5,577.46
Shpenzimet e fushatës			

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023

Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Gjithsei shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Fumizimi i zyrës	3.85	3.85	0.00
Pajisjet të vogla	13.9	13.9	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	3.87	3.87	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	45,254.43	4,893.88	40,360.55
Telefoni, interneti dhe posta	521.76	475.00	46.76
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	10,148.90	10,148.90	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	1,456.39	0.00	0.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	57,381.48	15,517.78	40,407.31
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe	1,908.69	1,908.69	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në	24,953.26	23,395.66	1,557.60
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	26,861.95	25,304.35	0.00
Gjithsej shpenzimet	717,543.90	661,714.24	54,373.27

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Mimoza Blakaj-Pitaqi	Prishtinë		06/02/2023	200.0	200.00	
Mimoza Blakaj-Pitaqi	Prishtinë		07/04/2023	100.0	100.00	
Mimoza Blakaj-Pitaqi	Prishtinë		12/11/2023	100.0	100.00	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				400.00	400.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i inallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		në Euro
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet					
Veturat	118,481.20	0.00	118,481.20	0.00	0.00
Pajisjet e zyrës	64,525.21	5,412.46	64,258.21	699.27	4,980.19
Pajisjet e teknologjisë informative	91,402.30	2,419.50	86,914.29	757.12	6,150.39
Pajisjet tjera	23,578.30	0.00	8,742.72	0.00	14,835.58
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	297,987.01	7,831.96	278,396.42	1,456.39	25,966.16

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
.... bleresi 1		
.... bleresi 2		
.... bleresi 3		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Parajanë bankë	1,024.23	36,691.19
Parajanë arkë	63.07	66.07
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,087.30	36,757.26

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËSShënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
.....fumitori 1	178,984.68	449,010.42
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	178,984.68	449,010.42

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	6,830.80	6,415.77
Detyrimet për qira	329.54	327.89
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	7,160.34	6,743.66

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Pagar ndaj:			Data kur është bere pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Marketing	Triumf Sadikaj	Prishtinë		Regjistri	12,683.76
Energjia Elektrike	Kesko	Prishtinë		Regjistri	10,150.00
Bileta Avioni	Travel One	Prishtinë		Regjistri	7,090.00
Shërbime Juridike-GP	Faton Fetahu	Prishtinë		Regjistri	5,720.00
Hulumtim Opinioni	Ubo-Consulting	Prishtinë		Regjistri	7,365.20
Marketing	Radio Televizioni i Kosovës	Prishtinë		Regjistri	10,000.00
Marketing	VM3 Sh.p.k	Prishtinë		Regjistri	11,276.24
Ushqim dhe pije	Nobel Restoran	Prishtinë		Regjistri	6,080.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					70,365.20